

## Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) përfundon vlerësimin e aftësive profesionale për kandidatët në garë për prokurorë të posaçëm<sup>1</sup>

- *Gjatë muajit qershor 2019 është mbyllur vlerësimi i aftësive profesionale për 23 kandidatët prokurorë për në Prokurorinë e Posaçme*

Vlerësimi i aftësive profesionale të kandidatëve për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar përbënte një nga hapat më të rëndësishëm në procesin e rivlerësimit me përparësi të kandidatëve nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) apo Kolegji i Posaçëm i Apelit (në rast ankimit).

Përpara konstituimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), kjo kompetencë u ushtrua nga institucioni i Prokurorisë së Përgjithshme, në kuadër të fillimit të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. [Në raportin mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2018](#), ky institucion informon për dorëzimin në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit të 83 raporteve të vlerësimit profesional të subjekteve prokuror/drejtues të rivlerësimit kalimtar.

Me krijimin e KLP në dhjetor 2018, një ndër kompetencat kryesore të këtij organi është edhe vlerësimi i aftësive profesionale të prokurorëve. Bazuar tek raporti i lartëpërmendur, me krijimin e KLP, 35 praktika në proces ndjekje me prioritet në grupin e punës të Prokurorisë së Përgjithshme ju dërguan/transferuan për kompetencë KLP-së me qëllim hartimin e raporteve të vlerësimit profesional të subjekteve prokuror/drejtues të rivlerësimit kalimtar.

Duke filluar nga muaji prill 2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka realizuar vlerësimin e aftësive profesionale për kandidatët për prokurorë të posaçëm duke e përmbyllur këtë proces gjatë [muajit qershor 2019](#). Ndërkohë KLP i ka kërkuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit rivlerësimin me

Ky numër i 9-të i SPAK Info, trajton ecurinë e rezultateve të vetting-ut për kandidatët prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe kandidatët gjyqtarë në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. KPK ka përshpejtuar ritmet e rivlerësimit për të gjithë këto kandidatë gjatë muajit qershor 2019.

Për shumë informacion mbi zbatimin e hapave ligjorë në drejtim të ngritjes së Gjykatave të Posaçme dhe SPAK mund të lexoni Buletinet 3-mujore SPAK Monitor të publikuara në faqen e CSDG: [www.csdgalbania.org](http://www.csdgalbania.org)

Publikimet realizohen në kuadër të projektit “Forcimi i informimit dhe pjesëmarrjes së publikut në zbatimin e reformës në drejtësi nëpërmjet monitorimit vlerësimit dhe komunikimit të procesit të ngritjes dhe funksionimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

<sup>1</sup> Prokurori kandidat për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Shkëlzen Cena është [dorëhequr](#) nga gara.

përparësi për këta kandidatë. Vendimi i dy organeve të fundit është përcaktues dhe i detyrueshëm për emërimin e prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme.


## Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) përshpejton rivlerësimin me përparësi për kandidatët prokurorë në Prokurorinë e Posaçme KKKO dhe kandidatët gjyqtarë në Gjykatat e Posaçme KKKO

- *KPK përfundon rivlerësimin për gjysmën e kandidatëve prokurorë për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar*

Rivlerësimi i kandidatëve për Strukturën e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (SPAK) është përcaktuar si një nga prioritetet kryesore nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, i cili me qëllim avancimin e këtij procesi ka pezulluar nëpërmjet një [vendimi](#) zhvillimin e shorteve të muajve maj, korrik, dhe shtator 2019, duke prioritarizuar vetting-un për kandidatët në organet e reja. Konkretisht, që nga muaji qershor KPK ka përshpejtuar ritmet e zhvillimit të seancave dëgjimore me kandidatët për prokurorë të posaçëm.

Me përfundimin e vlerësimit të aftësive profesionale për 23 kandidatët nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, KPK ka përfunduar gjatë muajit qershor 2019 rivlerësimin për gjysmën e tyre dhe ka dhënë vendimet përkatëse, nëpërmjet të cilave ka konfirmuar në detyrë 10 prokurorë dhe ka shkarkuar [1 prej tyre](#) duke sjellë vazhdimin e garës për 22 kandidatë. Ndërkohë, gjatë muajve në vijim priten të zhvillohen seancat dëgjimore për 12 prokurorët e tjerë.

Megjithatë, edhe pa përfundimin e rivlerësimit të 12 prokurorëve, Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të vijojë me hapat e tjerë ligjorë në funksion të renditjes së 22 kandidatëve për 15 pozicionet vakante në Prokurorinë e Posaçme. [Kryetari i KLP](#) ka deklaruar që faza pasuese, sikurse parashikohet edhe në [Rregulloren](#) respektive, do të jete intervistimi i kandidatëve gjatë datave [8-12 korrik](#). Pas përfundimit të kësaj faze, KLP do të realizojë renditjen e 22 kandidatëve sipas [sistemit të pikëzimit](#) të parashikuar në Rregullore, procese këto të parashikuara të përmbyllen gjatë muajit [korrik 2019](#).




Për të realizuar emërimin e 15 prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, KLP duhet të presë konfirmimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Megjithatë, nevoja për ngritjen sa më të shpejtë të institucionit kryesor të hetimi për veprat e korrupsionit dhe krimit të organizuar, [ka risjellë](#) në diskutim çështjen e [fillimit të veprimtarisë](#) së këtij organi edhe me një numër më të vogël prokurorësh, qoftë edhe me më pak se 10. Gjithsesi, ky [vendim](#) do të jetë një vendim kolegjal i KLP, i cili do të bazohet jo vetëm në nevojën për mos zgjajtje të mëtejshme në kohë për ngritjen e Prokurisë së Posaçme, por edhe bazuar në një analizë të përmbushjes së nevojave dhe volumit të punës që parashikohet të ketë ky institucion.

Gjithashtu një nga hapat më të rëndësishëm mbetet koordinimi për ngritjen e harmonizuar të organeve të hetimit dhe gjyqimit të veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Për [rëndësinë](#) që paraqet ky koordinim për respektimin e të drejtave dhe garancive të personave për një gjykim të drejtë, [KLGJ](#) dhe KLP kanë deklaruar angazhimin e tyre, dhe deri tani ecuria e procesit për ngritjen e organeve të reja po ecën pa diferenca të theksuara.

- *Përfundon vetting-u për 36% të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda: KPK përfundon rivlerësimin për pjesën më të madhe të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda*

Ndërkohë që [pjesa më e madhe](#) e gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda kanë pranuar të japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, proces i nisur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor që në muajin dhjetor 2018, edhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka përsheptuar procedurat për zhvillimin e seancave dëgjimore me gjyqtarë të këtyre Gjykatave. Si rezultat, pas një shkëputje disa mujore, KPK gjatë periudhës prill-qershor 2019 ka zhvilluar disa seanca dëgjimore me gjyqtarët e Gjykatës së Krimeve të Rënda, duke dhënë vendimet respektive për konfirmimin apo shkarkimin e tyre.

Vendimet e KPK dhe kalimi me sukses i procesit të vetting-ut janë përcaktuese për emërimin e përherhshëm të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në të njëjtën kohë, po kaq i rëndësishëm është edhe vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA) në rastet kur vendimet e KPK janë ankimuar në shkallën e dytë të vetting-ut. Deri në muajin qershor 2019, KPK ka përfunduar rivlerësimin për pjesën më të madhe të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda (rreth 73%), ndërkohë që nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda i është nënshtruar vetting-ut vetëm 1 gjyqtar nga 14 gjyqtarë që ka kjo Gjykatë.



Në të njëjtën kohë, po kaq i rëndësishëm mbetet fakti i raportit të gjyqtarëve të konfirmuar në detyrë kundrejt atyre të shkarkuar. Megjithëse ku trend deri tani ka qenë pozitiv, në favor të numrit të gjyqtarëve të konfirmuar në detyrë. Ecuria e mëtejshme e procesit me të njëjtin trend është thelbësore për shmangien e vonesave në plotësimin e vendeve për gjyqtarë në Gjykatat e Posaçme KKKO, të cilat do të përbëhen nga 16 gjyqtarë në Shkallën e Parë dhe 11 gjyqtarë në Gjykatën e Apelit.

## Statusi i procesit të rivlerësimit të Gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda kandidatë për në Gjykatat e Posaçme KKKO

Gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda kandidatë për në Gjykatat e Posaçme KKKO			Statusi & Vendimi i KPK
<b>Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda</b>			
1.	Sandër Simoni	Kryetar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
2.	Ardit Mustafaj	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
3.	Irena Gjoka	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
4.	Daniela Shirka	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
5.	Etleva Deda	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
6.	<b>Luan Hasneziri</b>	<b>Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë</b>	<b>Shkarkuar</b>
7.	Flora Hajredinaj	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
8.	Fran Prendi	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
9.	Ilirjana Olldashi	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
10.	Liljana Baku	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
11.	Marsela Balili	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
12.	Bib Ndreca	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
13.	Miliana Muça	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
14.	Klodian Kurushi	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
<b>Gjykata e Apelit për Krime të Rënda</b>			
1.	<b>Fehmi Petku</b>	<b>Kryetar/Gjykata e Apelit</b>	<b>Shkarkuar</b>
2.	Gjovalin Pernoca	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
3.	<b>Nertina Kosova</b>	<b>Gjyqtare/Gjykata e Apelit</b>	<b>Konfirmuar/APELUAR në KPA</b>
4.	Dhurata Haveri	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
5.	Nure Dreni	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
6.	<b>Saida Dollani</b>	<b>Gjyqtare/Gjykata e Apelit</b>	<b>Konfirmuar</b>
7.	<b>Dhimitër Lara</b>	<b>Gjyqtar/Gjykata e Apelit</b>	<b>Konfirmuar</b>
8.	<b>Sokol Binaj</b>	<b>Gjyqtar/Gjykata e Apelit</b>	<b>Konfirmuar</b>
9.	<b>Gurali Brahimllari</b>	<b>Gjyqtar/Gjykata e Apelit</b>	<b>Shkarkuar</b>
10.	<b>Idriz Mulkurti</b>	<b>Gjyqtar/Gjykata e Apelit</b>	<b>Shkarkuar</b>
11.	<b>Albana Boksi</b>	<b>Gjyqtare/Gjykata e Apelit</b>	<b>Konfirmuar</b>

\* Statusi i rivlerësimit është përditësuar për herë të fundit në datën 30 Qershor 2019

## Statusi i procesit të rivlerësimit të prokurorëve kandidatë për në Prokurorinë e Posaçme KKKO

Kandidatët e <b>KUALIFIKUAR</b> për të vazhduar garën për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (KKKO)			Raportet për Analizimin e Aftësive Profesionale	Statusi & Vendimi i KPK*
1.	Altin Dumani	Prokuror/Prokuroria e Apelit Tiranë	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
2.	Anita Jella	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
3.	Anton Martini	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar	Në proces rivlerësimi
4.	Arben Kraja	Prokuror/Prokuroria e Përgjithshme	Përfunduar	<b>Konfirmuar</b>
5.	Behar Dibra	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	<b>Konfirmuar</b>
6.	Besim Hajdarmataj	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar	Në proces rivlerësimi
7.	Besnik Muçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar	<b>Konfirmuar/ANKIMUAR në KPA</b>
8.	Doloreza Musabelliu	Prokurore/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
9.	Donika Prela	Drejtuese/Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda	Përfunduar	<b>Konfirmuar/ANKIMUAR në KPA</b>
10.	Dorina Bejko	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
11.	Dritan Prençi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar	<b>Konfirmuar</b>
12.	Edvin Kondili	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	<b>Konfirmuar</b>
13.	Elida Kaçkini	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
14.	Elizabeta Imeraj	Drejtuese/ Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
15.	Ened Nakuçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	<b>Konfirmuar</b>
16.	Enkeleda Millonai	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan	Përfunduar/Miratuar nga KLP	<b>Konfirmuar</b>
17.	Enkeleda Xhengo	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
18.	Eugen Beçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	<b>Shkarkuar</b>
19.	Klodian Braho	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
20.	Maksim Sota	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
21.	Manjola Kajani	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	<b>Konfirmuar</b>
22.	Ndini Tavani	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
23.	Vladimir Mara	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	<b>Konfirmuar</b>

\* Statusi i rivlerësimit është përditësuar për herë të fundit në datën 30 Qershor 2019